



Buletini nr. 164 – Korrik - 2017- Zyra për Informim Publik - <https://kk.rks-gov.net/malisheve/>



KOMUNA E MALISHEVËS



BULETINI

Buletini nr. 164- Korrik - 2017- Zyra për Informim Publik - <https://kk.rks-gov.net/malisheve/>



Pamje gjatë ushtrimit fushorë "Mirusha 2017"



Permbajtja:

Malisheva e përgatitur për korrjen e grurit	2
77.72 përqind e maturanëve e kanë kaluar testin e maturës.....	4
Inspektohen punimet në stadiumin e qytetit.....	5
Ka përfunduar vaksinimi dhe dehelmentalizimi i qenve shtëpiak.....	5
Ushtrimi fushor “Mirusha 2017”, mbahet më 11 dhe 12 korrik	6
Filloi ndërtimi i objektit të shkollës në Llazicë	7
Asnjë rast i infektuar nga ethet hemorragjike	7
U mbajt ushtrimi fushor “Mirusha 2017”	8
Kryetari Begaj, mbajti debatin e parë publik për vitin 2017	9
Komuna dhe qytetarët, ndihmojnë familjet skamnore në ndërtim të shtëpive	10
Ka filluar shenjëzimi i rrugëve në qytet	11
KK i Malishevës, ndalon “ekskursionet” e nxënësve jashtë vendit	12
U përkujtuan pesë dëshmorët të rënë 19 vite më parë	13
Ekipi i femrave në futboll “Malisheva”, pjesë e Superligës së Kosovës.....	13
KK i Malishevës, emërtoi një shesh dhe mori disa vendime tjera	14
Rendimentet e grurit në Malishevë, u sollën rreth 4200 kg për një hektar.....	15
Promovohet kultivimi i bimëve mjekuese dhe aromatike në Komunën e Malishevës	15
Shfaqja “Ehh letrat!”, fituese e çmimit për regjinë më të mirë në festivalin “Të rinjtë në skenë”	17
“Besa” dhe “Termopan”, fituese të kupës në not “Esmir Shala”	17
Klubi i notit “Besa”, shënoi 40 vjetorin e themelimit	18
Komuna e Malishevës, përkrahë 150 bujq me motokultivator	19

Malisheva e përgatitur për korrjen e grurit



Malishevë, 3 korrik

Drejtoria Komunale për Bujqësi, i ka bërë të gjitha përgatitjet për fushatën e korrje shirjeve të këtij viti. Kështu u bë e ditur në mbledhjen e rregullt të së hënës, të Këshillit të Drejtorëve, e cila është drejtuar nga nënkryetari i Komunës së Malishevës, Rexhep Mazreku. Po ashtu në këtë mbledhje u bë e ditur se korrjet kanë filluar, por janë ndërprerë për shkak të motit.

Sipas drejtorit të Drejtorisë për Bujqësi, Murat Hoxha, kjo drejtori i ka bërë të gjitha përgatitjet për fushatën e korrje shirjeve, ku është formuar edhe shtabi për mbikëqyrjen e kësaj fushate. Hoxha tha se “rendimentet e pritura janë 4000 kilogram për një hektar, ndërsa të mbjella me grurë janë 3895 hektarë”.

Edhe Drejtoria e Inspektoratit, ka bërë të ditur se kanë filluar me mbikëqyrjen apo inspektimin e mullinjve të cilët do ta pranojnë grurin e këtij viti.

Përndryshe, në këtë mbledhje u tha se është duke u vazhduar me realizimin e projekteve sipas planifikimeve, ndërsa gjatë këtij viti, pritet të hyjnë në funksion edhe katër objekte të reja shkollore.

Sa i përket shkollave, Drejtoria për Arsim dhe Edukim, përkatësisht drejtori Avdi Morina, tha se krahas regjistrimit të nxënësve, janë duke u bërë edhe përgatitjet tjera për fillimi e vitit të ri shkollor 2017-2018.

Përgatitje janë duke u bërë edhe për mbajtjen e Festivalit Tradicional të Folklorit “Oda e Llapushës”. Këtë e ka bërë të ditur drejtoresha e Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport, Blerta Krasniqi, sipas së cilës çdo gjë është po shkon mirë dhe festivali do të mbahet ashtu sikur edhe është i planifikuar në ditët e para të gushtit, në kuadër të shënimeve me rastin e “Ditëve të Mërgatës”.

Ardhja e mërgimtarëve për pushime në vendlindje, bën që të ketë edhe fluks më të madh të atyre që kërkojnë shërbime komunale, dhe për këtë shkak, sipas drejtorit të Drejtorisë së Administratës, Hajrullah Mazreku, “janë të përgatitur për këtë fluks të qytetarëve tanë, të cilët kërkojnë shërbime dhe pjesa e mërgatës do të vazhdoj të mbetet prioritet, për ofrimin e shërbimeve, në mënyrë që mërgimtarët të mos kenë asnjë lloj vonese për çdo lloj dokumenti që kërkojnë”.



77.72 përqind e maturantëve e kanë kaluar testin e maturës

Malishevë, 4 korrik

Testin e Maturës Shtetërore, në Malishevë, e kanë kaluar 77.72 përqind e maturantëve të cilët i janë nënshtruar këtij testi. Kështu ka njoftua sot, Drejtorja për Arsim dhe Edukim (DAE) në Komunën e Malishevës. me këtë rast, DAE në Malishevë, uron nxënësit, prindërit dhe mësimdhënësit për suksesin e arritur.

Njëkohësisht DAE në Malishevë çmon punën e komisioneve dhe të gjithë personelit të angazhuar, të cilët mundësuan mbarëvajtjen e testit të maturës shtetërore.

“Ky rezultat pozitiv është arritur nga përkushtimi i stafit të mësimdhënësve, organizimit të mirë, monitorimit të mirë dhe kushteve të mira, që institucionet tona ofruan për realizimin këtij testi, që hap perspektiva të reja për nxënësit tanë”, thuhet në njoftimin e drejtorit të Drejtorisë për Arsim dhe Edukim, Avdi Morina.

Nr.	Shkolla	Nr. i nxënësve që ju kanë nënshtruar Provimit të Maturës	Nxënës që kanë kaluar pragun e kalueshmërisë	Përqindja	Nxënës që nuk e kanë kaluar Provimin
1	Qendra e Kompetencës "Kujtim Krasniqi" Malishevë	155	85	54.87%	70
2	Gjimnazi "Hamdi Berisha" Malishevë	424	372	87.73%	52
3	SHMP" Lasgush Poradeci" Kijevë	90	63	70.00%	27
	Totali	669	520	77.72%	149



Inspektohen punimet në stadiumin e qytetit

Malishevë, 7 korrik

Stadiumi i qytetit në Malishevë, pritet të bëhet gati për sezonin e ri të garave, ku ekipi i futbollit nga Malisheva, garat do të zhvilloj në këtë stadium e jo në stadione të komunave fqinje. Po ashtu, është duke u punuar në ndërtimin e shtigjeve të atletikës. Këto punime sot i kanë inspektuar nënkryetari i Komunës së Malishevës, Rexhep Mazreku dhe drejtoresha për Kulturë, Rini dhe Sport, Blerta Krasniqi.



Punimet janë duke vazhduar me intensitet të lartë që renovimi dhe përgatitja e stadiumit të jetë i gatshëm sa më shpejt që është e mundur, në mënyrë që të jetë në funksion për sezonin e ri në garat e futbollit. Aktualisht po punohet në përgatitjen e fushës.

Po ashtu, në të njëjtën kohë, në këtë stadium po punohet edhe në ndërtimin e shtigjeve të atletikës, ku do të mund të zhvillohen garat në atletikë dhe do të jetë njëri nga stadiumet e rralla në vend, që do të ketë edhe shtigjet e atletikës.

Mazreku e Krasniqi, janë ndarë të kënaqur me ecurinë e deritanishme të punimeve në renovimin dhe përgatitjen e stadiumit, dhe kanë kërkuar që çdo gjë që punohet me standarde, përfshi edhe terrenet për atletikë, në mënyrë që të mund të zhvillohen të gjitha garat.

Ka përfunduar vaksinimi dhe dehelmentalizimi i qenve shtëpiak

Malishevë, 7 korrik

Këto ditë ka përfunduar procesi i vaksinimit dhe dehelmantizimit të qenve shtëpiak, në territorin e Komunës së Malishevës. Kështu ka njoftuar sot, drejtori i Drejtorisë për Bujqësi, Murat Hoxha, sipas të cilit, ky proces ka përfunduar me sukses dhe janë vaksinuar rreth 1500 qen, të cilët kanë pronarë dhe mbahen në shtëpi.



Sipas drejtorit Hoxha, vaksinimin e ka kryer stacioni i veterinarisë “Enkel-Med-Vet” në Malishevë dhe është kryer me sukses vaksinimi dhe dehelmantizimi i 1500 qenve në të gjitha fshatrat e Komunës së Malishevës.

Komuna e ka përkrahur këtë projekt, ndërsa vaksinat dhe tabletat për vaksinimin dhe dehelmantizimin e 1500 qenve, janë sigurua nga Agjencioni i Ushqimit dhe Veterinës (AUV) i Kosovës.

Ushtrimi fushor “Mirusha 2017”, mbahet më 11 dhe 12 korrik

Malishevë, 7 korrik

Ushtrimi fushor “Mirusha 2017”, do të mbahet më 11 dhe 12 korrik dhe për mbajtjen e këtij ushtrimi janë bërë të gjitha përgatitjet nga ana e Komunës së Malishevës dhe Agjencionit për Menaxhimin e Emergjencave (AME). Ushtrimi do të bëhet me qëllim të vlerësimit të kapaciteteve reaguese në rastet emergjente që mund të ndodhin.

Për organizimin e këtij ushtrimi, sot është mbajtur takimi i fundit i ekipit punues, i cili është drejtuar nga nënkryetari i Komunës së Malishevës, Rexhep Mazreku, ku edhe është prezantuar edhe skenari i mbajtjes së këtij ushtrimi.

Qëllim i ushtrimit fushor “Mirusha 2017”, është menaxhimi i situatave emergjente, vendimmarrja në këto raste, koordinimi i aktiviteteve të qeverisë komunale, organizatave vullnetare dhe sektorit privat dhe reagimi i tyre në situata emergjente apo në incidente të mëdha. Po ashtu qëllim tjetër është edhe testimi dhe përmirësimi i operacioneve emergjente, alarmimit, reagimit, evakuimit, strehimit, kujdesit në masë dhe fuqizimi i koordinimit dhe bashkëpunimit ndërinstytucional.

Më datë 11 korrik 2017, do të mbahet “ushtrimi në tavolinë”, ndërsa më 12 korrik do të mbahet ushtrimi fushor është i planifikuar të mbahet në dhe rreth liqenit në Mirushë. Në këtë ushtrim do të jenë të përfshira të gjitha ekipet e reagimit dhe të emergjencave, si njësitë e zjarrfikësve dhe shpëtimit, Policia e Kosovës, ekipet shëndetësore, organizatat vullnetarë dhe sektori privat. Gjatë ushtrimit do të inskenohen tri aksidente, ku përfshihen vërshimet, aksident në komunikacion dhe aksident zjarri.

I gjithë ushtrimi do të mbikëqyret dhe vlerësohet nga AME, UNDP dhe organizmat tjerë.

Me këtë rast, luten qytetarët e Komunës së Malishevës, që të mos shqetësohen gjatë mbajtjes së ushtrimit dhe në rastet e caktuara, të shfrytëzojnë rrugët alternative për lëvizjen e tyre. Në fillim të javës së ardhshme, qytetarët do të njoftohen në hollësi për ushtrimin fushorë “Mirusha 2017”.



Filloi ndërtimi i objektit të shkollës në Llazicë

Malishevë, 10 korrik

Sot në fshatin Llazicë, ka filluar ndërtimi i objektit të shkollës. Në ceremoninë e vënies së gurëthemelit të objektit të shkollës, mori pjesë edhe Kryetari i Komunës së Malishevës, Ragip Begaj, dhe me këtë rast i ka uruar banorët dhe mësimdhënësit e kësaj shkolle, për fillimin e ndërtimit të objektit të ri të shkollës, e cila do të jetë e ndërtuar sipas standardeve.



“Arsimi është dhe do të mbetet prioritet i yni, prandaj edhe jemi të angazhuar maksimalisht në krijimin e kushteve sa më të mira për mësimdhënie dhe mësimnxënie, në të gjitha shkollat e Komunës së Malishevës. Për të krijuar kushte më të mira për mësim, po e ndërtojmë edhe këtë objekt shkollor në fshatin tuaj. Ne e kemi obligim të krijojmë kushte, ndërsa ju si mësimdhënës, të tregoni rezultate dhe cilësi. Juve banorë të Llazicës, ju uroj për shkollën e re”, tha mes tjerash kryetari Begaj, me rastin e fillimit të ndërtimit të objektit të ri të shkollës në Llazicë.

Ahmet Morina, drejtori i Drejtorisë së Urbanizmit, si përgjegjës për ndërtimin e këtij objekti shkollor, tha se ky objekt duhet të përfundojë sipas planifikimeve, brenda 18 muajve. Objekti do të ndërtohet sipas standardeve dhe do të plotësojë nevojat e shkollës, që mësimi të mbahet në një ndërrim.

Asnjë rast i infektuar nga ethet hemorragjike

Malishevë, 10 korrik

Deri më tani nuk është regjistruar asnjë rast i infektimit me ethe hemorragjike (EHKK), ndërsa edhe numri i rasteve të pickimeve nga rriqrat është në rënie, në raport me vitet e kaluara. Kështu është bërë e ditur në mbledhjen e rregullt të Këshillit të Drejtorëve, e cila është udhëhequr nga kryetari i Komunës së Malishevës, Ragip Begaj.



Drejtori i Drejtorisë për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale, Hajdin Berisha, duke raportuar në mbledhjen e sotme, tha se “pothuajse kanë përfunduar së realizuari të gjitha masat mbrojtëse në raport me luftimin dhe parandalimin e EHKK dhe aktualisht është duke u realizuar vetëm edhe faza e katërt e repelimit të kafshëve”. Më pas drejtori Berisha, konfirmoi se nuk ka asnjë rast të regjistruar me ethe hemorragjike, ndërsa edhe numri i rasteve të thumbimeve nga rriqrat, është në rënie.

Gjatë raportimeve të tyre, përgjegjësit e drejtorive komunale, bënë të ditur se janë duke vazhduar me realizimin e planifikimeve të tyre, si dhe janë duke u realizuara të gjitha projektet e kontraktuara dhe sipas planifikimeve.

Në këtë mbledhje, drejtori i Drejtorisë për Mbrojtje dhe Shpëtim, Sejdi Paçarizi, ka bërë të ditur se janë përgatitur për mbajtjen e ushtrimit fushor “Mirusha 2017”, që do të mbahet më 11 dhe 12 korrik (të martën dhe të mërkurën e kësaj jave). Drejtori Paçarizi, gjithashtu ka bërë të ditur se gjatë natës së mbrëmshme, për shkak të erërave të fuqishme, janë shkaktuar disa dëme në kulme të shtëpive dhe dëme tjera, kryesisht në fshatin Carrallukë dhe për këtë qëllim ekipet vlerësuese kanë dalë në terren për verifikimin e dëmeve.

U mbajt ushtrimi fushor “Mirusha 2017”

Malishevë, 12 korrik



privat.

Për dy ditë me radhë, në Malishevë, organizuar nga Komuna e Malishevës, në bashkëpunim me Agjencionin për Menaxhimin e Emergjencave (AME), UNDP dhe Bedrin, është mbajtur ushtrimi fushor “Mirusha2017”. Në këtë ushtrim ishin të kyçura të gjitha institucionet përgjegjëse lokale dhe AME, si dhe organizatat joqeveritare, pastaj kompanitë për menaxhimin e ujërave dhe mbeturinave, si dhe sektori

Qëllim i këtij ushtrimi fushor ishte vlerësimi i kapaciteteve të organeve lokale, në rastet emergjente si në rastet e vërshimeve, zjarreve dhe aksidenteve të mundshme, ngritja e



kapaciteteve lokale menaxhuese dhe reaguese në rastet e fatkeqësive natyrore dhe fatkeqësive tjera.

Në këtë ushtrim kanë marrë pjesë ekipet reaguese dhe të emergjencave, si Drejtoria për Mbrojtje dhe Shpëtim, ekipet e Zjarrfikësve dhe Shpëtimit, Policia e Kosovës, Urgjenca dhe Kryqi i Kuq.

Gjatë ditës së djeshme është zhvilluar një ushtrim në tavolinë, ku janë parë mënyrat e intervenimit, duke filluar nga ngritja e Këshillit Komunal për Mbrojtje dhe Shpëtim e deri në intervenim, në rastet e caktuara emergjente.

Ndërsa gjatë ditës së sotme, në mënyre praktike është zhvilluar ushtrimi, ku pas marrjes së informacionit për vërshime si pasojë e motit me shi, breshër dhe vetëtima, në pjesën e Mirushës, ku një grup studentësh dhe mësuesve, që ishin duke pushuar afër liqenit, si dhe disa peshkatar, janë lënduar si pasojë e vërshimeve, ku dy prej tyre kanë marr lëndime të rënda trupore, tre të tjerë lëndime të lehta dhe disa persona të tjerë janë traumatizuar nga situata. Një peshkatar ka njoftuar për situatën dhe me të marr informacionin për situatën, zyrtarët e Drejtorisë për Mbrojtje dhe Shpëtim, kanë informuar Kryetarin e Komunës për situatën dhe kanë propozuar aktivizimin e Këshillit Komunal për Mbrojtje dhe Shpëtim, pastaj, pas aktivizimit të këtij këshilli, është caktuar komandanti i incidentit, i cili edhe e ka udhëhequr tërë operacionin.

Ekipet reaguese të kërkim shpëtimit në ujëra, urgjenca dhe Policia e Kosovës, kanë reaguuar, duke krijuar perimetrin e sigurisë, duke i kërkuar të lënduarit, bartjen dhe tërheqjen e tyre në vend të sigurt, trajtimin mjekësor, evakuimin e personave të tjerë, trajtimin e personave të traumatizuar dhe strehimin e personave të rrezikuar nga vërshimet. Ndërsa Kryqi i Kuq, ka bërë trajtimin e të traumatizuarve, si dhe ka ngritur tenda për strehimin e personave të rrezikuar.

Pas kësaj është inskenuar një rast zjarri, me persona të lënduar brenda objektit, edhe në këtë rast janë ndjekur procedurat e njëjta të intervenimit, sikur edhe në intervenimin e tretë, në një rast aksidenti më të lënduar.

Në fund të ushtrimit është bërë edhe një analizë e realizimit të këtij ushtrimi fushor, ku janë analizuar ndjekja e procedurave për rastet e tilla emergjente, vendimmarrja dhe realizimi i operacionit në të tri rastet emergjente.

I tërë ky ushtrim fushor, është vëzhguar nga vëzhgues përgjegjës vendor dhe ndërkombëtar, si dhe është përcjellë nga vlerësuesit profesional, vendor dhe të huaj, të cilët do i japin vlerësimet e tyre për këtë ushtrim, ku përmes kësaj do të shikohen përparësitë dhe mangësitë eventuale, për menaxhimin e emergjencave dhe do të vlerësohen kapacitetet e Komunës së Malishevës në rastet e tilla.

Kryetari Begaj, mbajti debatin e parë publik për vitin 2017



Malishevë, 13 korrik



Kryetari i Komunës së Malishevës, Ragip Begaj, ka mbajtur sot takimin e parë publik për vitin 2017, lidhur me realizimin e projekteve dhe buxhetit komunal, në gjysmë vjetorin e parë të këtij viti. Me këtë rast, kryetari Begaj, i ka informuar qytetarët lidhur me punët dhe aktivitetet në gjashtë mujorin e parë të këtij viti, dhe më pas është zhvilluar edhe debat me të pranishmit.

Fillimisht, është prezantuar botimi i një fletëpalosje, lidhur me buxhetin dhe investimet e Komunës së Malishevës, në gjashtë mujorin e parë të këtij viti, botimi i së cilës është mundësuar nga OSBE dhe më pas, në mënyrë kronologjike, kryetari i ka informuar qytetarët për investimet dhe buxhetin e shpenzuar gjatë periudhës janar-qershor 2017.

Bazuar në këtë raport, buxheti komunal është shpenzuar në masën 47.62 për qind, ndërsa në pjesën e investimeve kapitale, nga 4.15 milion, është shpenzuar në masën 42.97 për qind e planifikimit. Sa i përket realizimit të projekteve, kryetari Begaj, tha se prioritet nga lista e investimeve kapitale, i është dhënë infrastrukturës shkollore, ku në gjashtë mujorin e parë është filluar me ndërtimin e tri objekteve të reja shkollore, pastaj vëmendje e veçantë i është dhënë edhe bujqësisë, infrastrukturës rrugore, ndërtimi i sistemeve të kanalizimeve, mirëmbajtja e tyre dhe projekte tjera. Të gjitha këto investime kapitale, kryetari Begaj, i ka përmendur një nga një.

Pas prezantimit të investimeve dhe shpenzimit të buxhetit komunal, është zhvilluar një debat me të pranishmit, të cilët, kryesisht kanë kërkuar më shumë investime, sidomos në rrjetet e kanalizimeve dhe në mirëmbajtjen e tyre. Po ashtu, ata kanë bërë edhe pyetje në të cilat është përgjigjur kryetari Begaj, apo përgjegjësit e drejtorive komunale.

Debat publike, apo takimet publike për punën e qeverisë komunale, bazuar në Ligjin për Vetëqeverisjen Lokale, Kryetari i Komunës është i obliguar ti mbajë dy takime të këtilla, brenda një viti.

Komuna dhe qytetarët, ndihmojnë familjet skamnore në ndërtim të shtëpive

Malishevë, 14 qershor



Komuna e Malishevës, në kuadër të investimeve në rritjen e mirëqenies sociale dhe krijimin e kushteve më të mira për jetë, edhe këtë vit ka ndarë një shumë të konsiderueshme të mjeteve për ndërtimin e shtëpive, për familjet të cilat e kanë problem strehimin. Kësaj ndihme i janë përgjigjur edhe qytetarët, pasi këto ditë, tre qytetarë nga Komuna e Malishevës, kanë dhënë donacion për ndërtimin e shtëpisë për familjen e Tefik Begajt nga Banja.

Këta donator, kanë dhënë donacion prej tre mijë euro (nga një mijë euro secili), ndërsa më herët edhe komuna kishte ndarë një shumë prej mbi dy mijë euro dhe me këto mjete, kjo familje e cila jeton në kushte të rënda ekonomike, do të ndërtoj shtëpinë dhe përfundimisht do të zgjidh problemin e strehimit.

Përndryshe, Komuna e Malishevës, përkatësisht Kryetari i Komunës, Ragip Begaj, sikur viteve tjera, edhe këtë vit ka marrë vendim për ndarjen e 90 mijë eurove, për ndërtimin e pesë shtëpive dhe për pesë shtëpi tjera ndërtimin e kulmeve.

Ka filluar shenjëzimi i rrugëve në qytet

Malishevë, 17 korrik



Si çdo të hëne edhe sot është mbajtur mbledhja e rregullt e Këshillit të Drejtorëve, i drejtuar nga Kryetari i Komunës së Malishevës, Ragip Begaj. Në këtë mbledhje, u tha se janë duke vazhduar punimet në projektet që kanë filluar më herët, ndërsa këto ditë ka filluar edhe shenjëzimi i rrugëve brenda qytetit të Malishevës.

Kryetari i Komunës së Malishevës, Ragip Begaj, në mbledhjen e sotme, ka përsëritur kërkesën e tij, në raport më drejtoritë përgjegjëse, që projektet të përfundojnë me kohë dhe të mos ketë vonesa, pasi siç tha kryetari Begaj, “nuk dua që projektet të realizohen gjatë fushatës zgjedhore, por të përfundojnë mundësisht para kohës së planifikuar dhe asgjë të mos lidhet me fushatën zgjedhore në tetor”.

Përndryshe, gjatë raportimit të drejtorëve të drejtorive, u bë e ditur se “ka filluar shenjëzimi i rrugëve brenda qytetit, por për shkak të shiut është ndërprerë dhe do të vazhdoj në ditët në vijim”, tha në raportin e tij drejtori i Shërbimeve Publike, Milazim Morina.



“Për shkak të reshjeve të shiut është ndërprerë edhe fushata e korrje shirjeve, e cila pritet të përfundoj brenda dy ose tri dite”, ka raportuar drejtori për bujqësi, Murat Hoxha, i cili gjithashtu tha se gjatë kësaj jave, përfundojnë të gjitha procedurat dhe nga java e ardhshme, pritet furnizimi i fermerëve me motokultivator, projekt i drejtorisë së bujqësisë.

Ndërsa drejtori për buxhet dhe financa, Vesel Krasniqi, duke prezantua raportin gjashtë mujor, tha se buxheti është realizuar sipas planifikimit, e sidomos pjesa e shpenzimeve në investimet kapitale, ku projektet janë realizuar sipas planifikimeve. Sa i përket realizimit të projekteve, u tha se janë duke vazhduar punimet në të gjitha projektet kapitale dhe deri më tani nuk ka vonesa.

Në mbledhjen e sotme, gjatë raportimeve të drejtorive, u tha se po vazhdojnë përgatitjet për organizimin e festivalit folklorik “Oda e Llapushës”, edicioni i katërt. Po ashtu, në këtë mbledhje u tha se edhe shërbimet komunale janë në vllugun e punës, sidomos në ofrimin e shërbimeve për qytetarët, e në mënyrë të veçantë për mërgimtarët.

Përgatitje janë duke u bërë edhe për fillimin e vitit të ri shkollor 2017-2018, ku janë planifikuar të hapen katër objekte të reja shkollore.

KK i Malishevës, ndalon “ekskursionet” e nxënësve jashtë vendit

Malishevë, 19 korrik

Kuvendi i Komunës së Malishevës, në mbledhjen e rregullt, e cila nuk ka përfunduar dhe do të vazhdoj të premtën e ardhshme, në mesin e shumë çështjeve që i ka trajtuar sot, ka marr edhe një vendim, përmes së cilit ju ndalohen ekskursionet e shkollave të mesme jashtë vendit, përjashtuar vizitat studimore apo ato me karakter edukativo-arsimor.

Zakonisht, maurantët në shkollat e mesme, kryesisht gjatë muajit shtator, organizojnë ekskursione në bregdetin shqiptar, mirëpo, me propozimin e anëtarit të KK të Malishevës, Januz Kastrati dhe Ahmet Rrahmanaj, ky lloj i ekskursionit është marrë vendim që të mos organizohet, përjashtuar vizitat me karakter studimor, arsimor dhe edukativ. Arsyetimi i atyre që kanë propozuar ishte se, po krijohen shpenzime të mëdha, pastaj ky lloj i vizitës është qëndrim në bregdet dhe jo ekskursion edukativ dhe arsimor. Anëtarët e KK, me shumicë të votave, praktikisht me përdorimin e votës së dyfishtë të kryesuesit, morën vendim që këto lloj të “ekskursioneve” të mos organizohen jashtë vendit, por ekskursionet të bëhen vetëm brenda vendit.



Përndryshe në mbledhjen e sotme të Kuvendit të Komunës së Malishevës, është shqyrtuar edhe raporti i Auditimit për raportin vjetor financiar, si dhe është shqyrtuar edhe raporti i Drejtorisë për Arsim dhe Edukim, për përfundimin e gjysmë vjetorit të dytë të vitit shkollor 2016-2017.

KK i Malishevës, gjithashtu mori vendim për përkrahjen e klubit të futbollit “UV Malisheva”, si dhe për mbështetjen financiare për mbajtjen e Festivalit Folklorik “Oda e Llapushës”, edicioni i katërt.

Mbledhja e shtatë e rregullt e Kuvendit të Komunës së Malishevës, do të vazhdoj punimet e saj të premten më 21 korrik, në ora 10:00.

U përkujtuan pesë dëshmorët të rënë 19 vite më parë

Malishevë, 19 korrik

Sot, me nderime në varrezat e dëshmorëve dhe në vendin e rënies, janë përkujtuar dëshmorët e kombit, Hamdi Berisha, Sadik Shala, Habib Berisha, Afrim Krasniqi dhe Liman Gegaj, të cilët ranë heroikisht në luftën e Rahovecit, 19 vite më parë. Nderime dhe homazhe ka bërë edhe Kryetari i Komunës së Malishevës, Ragip Begaj.

Të pesë dëshmorët, ranë 19 vite më parë, gjatë luftimeve në qytetin e Rahovecit dhe në mbrojtje të popullatës civile.

Ata sot u përkujtuan nga familjarët, bashkëluftëtarët dhe strukturat udhëheqëse të Komunës së Malishevës, në krye më kryetarin Ragip Begaj.

Fillimisht, janë bërë homazhe në varrezat e dëshmorëve dhe më pas edhe në vendin e rënies në Rahovec, ku edhe janë ngritur lapidarë në nderim të pesë dëshmorëve të kombit, pjesëtarë të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës.

Ekipi i femrave në futboll “Malisheva”, pjesë e Superligës së Kosovës



Malishevë, 21 korrik

Klubi i futbollit të femrave KFF “Malisheva” nga Malisheva, do të garoj në superligën e Kosovës në futboll për femra. Për këtë qëllim, sot, Kryetari i Komunës së Malishevës, Ragip Begaj dhe drejtoresha për Kulturë, Rini dhe Sport, Blerta Krasniqi, i kanë pritur në një takim, kryesinë e klubit, të cilët i kanë uruar për klubin dhe ju kanë dëshiruar suksese në garat e nivelit më të lartë të futbollit për femra.

“Ndoshta mundësitë tona buxhetore na kufizojnë në përkrahjen për klubin, por përkrahja e komunës nuk do të mungoj, ndërsa juve ju dëshiroj që të keni suksese në këtë nivel të garave në futboll”, ju tha kryetari Begaj.

Ndërsa drejtoresha Blerta Krasniqi, tha se “është shumë pozitive formimi i klubeve të ndryshme sportive, e në veçanti i klubeve për femra, e sidomos në futboll, prandaj ne do të bëjmë çmos që t’iu përkrahim, edhe pse kemi shumë pak mundësi buxhetore”. “Por pavarësisht kësaj ne urojmë që të keni sukses në gara, dhe i inkurajoj femrat që të merren sa më shumë me sport, në këtë rast me futboll”, tha Krasniqi.

Kryesia e klubit të futbollit KFF “Malisheva”, falënderuan kryetarin Begaj dhe drejtoreshën Krasniqi për pritjen, ndërsa shpalosën para tyre edhe projektin dhe synimet e klubit në superligën e Kosovës në futboll për femra.

Po ashtu, ata kërkuan edhe mbështetje nga ana e komunës, në mënyrë që ekipi të mund të funksionoj dhe të zhvilloj garat dhe stërvitjet, përderisa sipas drejtuesve të klubit edhe interesimi dhe dëshirave e femrave, për të qenë pjesë e ekipit është shumë e madh dhe gjithnjë e më shumë po rritet interesimi i vajzave, për tu marr me sportin e futbollit, si një nga sportet më atraktive.

KK i Malishevës, emërtoi një shesh dhe mori disa vendime tjera

Malishevë, 21 korrik

Sot, kanë vazhduar punimet e mbledhjes së shtatë të Kuvendit të Komunës së Malishevës, ku gjithashtu janë marr disa vendime, e në mesin e këtyre vendimeve, është emërtimi i sheshit, tek ish tregu i vjetër, me emrat e dëshmorëve Sadik e Ramiz Shala dhe Haxhi Kleçka.

KK i Malishevës, ka miratuar edhe raportin e punës së Komitetit për Komunitete për vitin 2016 dhe planin e punës për këtë vit. Gjithashtu KK ka miratuar edhe kërkesën e peticionit të lagjes së



Gurit në Malishevë, për formimin e një komisioni i cili do të shqyrtonte një kërkesë për një rrugë në këtë lagje.

Në mbledhjen e sotme, Kuvendi i Komunës së Malishevës, me shumicë të votave, ka miratuar kërkesën e grupit të NISMA, për zëvendësimin e anëtares së KPF-së, Behije Sertolli, e cila e ka ndërruar subjektin politik, duke kaluar në LVV, dhe atë e kanë zëvendësuar me anëtarin e saj në KK të Malishevës, Veton Kastrati.

Pikë tjetër, e cila është shqyrtuar në mbledhjen e sotme, është raporti i komisionit, i cili është marr me verifikimin e dhënies në shfrytëzim të pronës publike, apo shpronësimin e pronës publike, nga koha e Qeverisë së Përkohshme, e deri në vitin 2015. Sipas raportit, në 19 raste, mendohet se mund të ketë parregullsi.

Rendimentet e grurit në Malishevë, u sollën rreth 4200 kg për një hektar

Malishevë, 24 korrik

Kryetari i Komunës së Malishevës, Ragip Begaj, sot ka mbajtur mbledhjen e rregullt të Këshillit të Drejtorëve, ku drejtorët e drejtorive kanë raportuar për punën e tyre gjatë javës së kaluar, si për planifikimet e tyre, për javën në vijim. Në këtë mbledhje, u tha se rendimentet e grurit në territorin e Komunës së Malishevës, kanë qenë rreth 4200 kilogram, për një hektar.

Përndryshe në mbledhjen e sotme, u tha se situata me ujë për pije është e rënduar në disa vendbanime, për shkak të thatësisë së madhe që po mbretëron dhe temperaturave tejet të larta gjatë korrikut.

Këtyre ditëve është rritur numri i personave të cilët kanë nevojë për nxjerrjen e dokumenteve të ndryshme, sidomos mërgimtarët, dhe për këtë qëllim janë marrë të gjitha masat për ofrimin e këtyre shërbimeve për të gjithë qytetarët dhe deri me tani nuk ka vonesa në kryerjen e shërbimeve dhe të gjitha këto shërbime, kryhen brenda orarit të punës.

Java në vazhdim do të jetë e pasur edhe me aktivitete të ndryshme, e në mesin e tyre edhe garat memoriale e notit, “Esmir Shala”, e cila do të mbahet të premten më 28 korrik, në Banjë. Po ashtu u bë e ditur se janë duke u bërë të gjitha përgatitjet për mbajtjen e festivalit “Oda e Llapushës, që do të mbahet më 1 dhe 2 gusht.

Promovohet kultivimi i bimëve mjekuese dhe aromatike në Komunën e Malishevës



Malishevë, 26 korrik



Sot në fshatin Tërpezë, përkatësisht në ambientet e kompanisë “AgroShqiponja”, është bërë promovimi i kultivimit të bimëve mjekuese dhe aromatike, projekt të cilin e përkrahë edhe USAID-i. Në këtë ceremoni mori pjesë Kryetari i Komunës së Malishevës, Ragip Begaj, përgjegjësi i USAID-it për bujqësi, Mike de la Rosa, drejtori komunal për bujqësi, Murat Hoxha dhe kultivues të këtyre bimëve nga Malisheva dhe komunat përreth, që bashkëpunojnë me këtë kompani të kultivimit dhe grumbullit të bimëve mjekuese dhe aromatike.

Me këtë rast, Kryetari i Komunës së Malishevës, Ragip Begaj, duke folur në këtë ceremoni të prezantimit, pasi foli për rëndësinë e marrjes me bujqësi, tha se “ne mund ta mbajmë vetveten përmes punës, sidomos në bujqësi dhe shembulli më i mirë është kompania “AgroShqiponja”. “Unë i inkurajoj të gjitha gratë fermere, të cilat po merren me këtë lloj të veprimtarisë, që të vazhdojnë me kultivimin e bimëve, pasi kemi kushte për këtë dhe jemi një vend ekologjik”, tha Begaj, duke premtuar përkrahjen e komunës, në kultivimin e bimëve të tilla, të cilat janë një mundësi e mirë zhvillimit.

Se kjo është një mundësi e mirë e zhvillimit të bujqësisë dhe zhvillimit ekonomik, e tha edhe përgjegjësi Mike de la Rosa, nga AGRO-USAID. “Përveç zhvillimit, ju po e prezantoni më së miri Kosovën, pasi këto bimë kultivohen në Kosovë. Po ashtu po shtohen vendet e punës, përmes kultivimit të bimëve të tilla dhe ky është edhe synimi ynë, që përmes rritjes së kësaj veprimtarie, të rritet edhe numri i të punësuarve”, tha de la Rosa.

Pronari i kompanisë “AgroShqiponja” nga Tërpeza, Shefqet Krasniqi, tregoi për fillimet e tij në kultivimin e bimëve mjekësore dhe aromatike, ku nga një biznes i vogël familjar, tani është bërë një kompani ku bëhet kultivimi, tharja, si dhe grumbullimi i bimëve të këtilla, para se të plasohen në treg. “Me këtë biznes, kam arritur ti shkolloj fëmijët e mi dhe rris numrin e të punësuarve, ku e tërë familja është e angazhuar dhe sot fëmija i im, e udhëheq kompaninë, kurse dhjetëra biznese, ose gra fermere, nga Malisheva, Suhareka, Rahoveci dhe komunat e tjera, i grumbullojnë bimët në kompaninë tonë”, tha Krasniqi, i cili i falënderoi të gjithë për përkrahje, duke filluar nga USAID-i, për përkrahjen e këtij programi në bujqësi, pastaj Komunën e Malishevës dhe të gjithë të tjerët, e në veçanti fermeret.



Shfaqja “Ehh letrat!”, fituese e çmimit për regjinë më të mirë në festivalin “Të rinjtë në skenë”

Malishevë, 27 korrik



Grupi teatral i Qendrës Rinore të Malishevës, ka marr pjesë në Festivalin e Teatrove “Të Rinjtë në Skenë”, i cili është mbajtur në Obiliq dhe është i pari festival i këtij lloji me karakter garues. Në këtë festival, grupi i teatrit të Qendrës Rinore, mori pjesë me shfaqjen “Ehh letrat!”, dhe në fund të festivalit, shfaqja ka marr çmimin e regjisë më të mirë.

Regjinë e shfaqjes e ka bërë Marigona Ferati, ndërsa kjo shfaqje ishte përgatitur në kuadër të projektit “Kryetarët mbështesin aktorët e rinj”, në bashkëpunim me “Mitrix Culture”.

“Besa” dhe “Termopan”, fituese të kupës në not “Esmir Shala”

Malishevë, 28 korrik



Sot në pishinat e Banjës së Malishevës, për herë të tretë radhazi, është mbajtur kupa memoriale në not “Esmir Shala”, ku ekipet “Besa” në konkurrencën e meshkujve dhe “Termopan” në konkurrencën e femrave, kanë dalë fituese të kësaj kupe, e cila është tradicionale zyrtare dhe e pranuar nga Federata e Notit të Kosovës. Kjo kupë, organizohet nga klubi i notit “Besa”, Federata e Notit të Kosovës dhe mbështetet nga Komuna e Malishevës, përkatësisht

Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport.

Garën e ka hapur i pari i Komunës së Malishevës, Ragip Begaj, i cili i ka urua të gjithë garuesit, si dhe ka shprehur kënaqësinë e tij, për pjesëmarrjen masive, në nderim të kampionit të Kosovës në not, Esmir Shala.



Në ceremoninë e fillimit të garës për kupën “Esmir Shala”, ka marr pjesë edhe kryetari i Federatës së Notit të Kosovës, Ymer Rama, i cili gjithashtu i ka uruar notarët dhe klubet, si dhe e ka përgëzuar klubin e notit “Besa”, për organizimin e kësaj kupe, tashmë tradicionale.

Kupa në not, “Esmir Shala”, është një garë memoriale, me karakter garues. Në këtë garë, këtë vit, kanë marr pjesë 12 ekipe të notit nga Kosova, me mbi 160 notarë, si dhe në garë kanë marr pjesë edhe veteranët e notit.

Bazuar në rezultatet e arritura, ekipi i notit “Besa”, në konkurrencën e meshkujve, doli e para me 416 pikë, në vendin e dytë ekipi “Termopan”, me 318 pikë dhe në vendin e tretë ekipi “Zenit”, me 140 pikë. Në konkurrencën e femrave, në vendin e parë doli ekipi “Termopan”, me 152 pikë, në vendin e dytë ekipi “Zenit”, me 108 pikë dhe në vendin e tretë “Besa”, me 73 pikë.

Në kategorinë e veteranëve, në stilin krol, më i mirë ishte Naser Buzhala, në stilin bretkosë, më i miri ishte Blerim Shala, i cili do ta përfaqësoj Kosovën në kampionatin botëror në kategorinë e veteranëve në Hungari, ndërsa në konkurrencën e femrave, në stilin bretkosë, ishte Liridona Limaj, të gjithë ish kampion të Kosovës në not.

Klubi i notit “Besa”, shënoi 40 vjetorin e themelimit

Malishevë, 29 korrik

Mbrëmë me një ceremoni të rastit, krenaria e sportit në Komunën e Malishevës, klubi i notit “Besa” nga Banja, krahas organizimit të kupës së notit “Esmir Shala, ka shënuar edhe 40 vjetorin e themelimit të klubit. Klubi i notit ”Besa”, jo vetëm që është klubi më i suksesshëm në Malishevë, por është klubi i notit më i suksesshmi në nivel të vendit.

Pas përfundimit të garave të djeshme, që mbanë emrin e ish kampionit “Esmir Shala”, nën organizimin e klubit, është festuar edhe 40 vjetori i formimit të klubit, ku krahas anëtarëve të tashëm, kanë marrë pjesë edhe veteranët e notit nga klubi “Besa”, shumica prej tyre ish kampion të Kosovës, si dhe punëtorët shumëvjeçar në sportin e notit. Në këtë shënim janë kujtuar të gjithë ata që kanë punuar për klubin, si dhe notarët të cilët ja kanë zbardhur fytyrën, jo vetëm klubit, por tërë Komunës së Malishevës, e më gjerë.

Klubi i notit “Besa”, e ruan epitetin e klubit më të suksesshëm kosovar në not, ku ka dhënë dhjetëra e dhjetëra kampion noti, por që nuk kanë munguar sukseset edhe në nivel të Federatës së ish Jugosllavisë, pjesë e cilës ka qenë edhe Kosova.



Edhe sot, ndonëse në kushte jo shumë të mira, klubi i notit “Besa”, vazhdon të jetë klubi më i suksesshëm në sportin e notit.

Komuna e Malishevës, përkrahë 150 bujq me motokultivator

Malishevë, 31 korrik

Në kuadër të subvencionimit në bujqësi, Komuna e Malishevës, sot ka filluar shpërndarjen e 15 motokultivatorëve për fermerët, përkatësisht bujqit e Komunës së Malishevës. Ku subvencionim, bëhet me qëllim të ndihmës në zhvillimin e bujqësisë në komunën tonë. Në fillimin e dhënies së motokultivatorëve, ka marrë pjesë edhe Kryetari i Komunës së Malishevës, Ragip Begaj, i shoqëruar nga drejtori për bujqësi, Murat Hoxha, të cilët edhe i kanë uruar bujqit përfitues.

“Unë besoj se kjo do t’iu ndihmon juve në aktivitetet e përditshme në bujqësi dhe ky edhe është qëllimi ynë, që t’ju krijojmë kushte sa më të mira për punë. Të gjithë ata që punojnë dhe e arsyetojnë punën e tyre, për neve si qeveri komunale, është obligim që ti përkrahim dhe kjo është zhvillim dhe krijim i të mirave materiale për veten e tyre dhe për vendin. Unë besoj se përkrahja për bujqësi do të vazhdojë edhe në të ardhmen dhe kjo është vetëm një pjesë e atyre subvencioneve që ne në vazhdimësi i kemi dhënë për bujqit”, tha mes tjerash kryetari Begaj.



të vazhdohet me përkrahjen e sektorit të bujqësisë”.

Kjo përkrahje e Komunës së Malishevës, është vetëm një prej subvencioneve të shumta në fushën e bujqësisë. Drejtori i Drejtorisë për Bujqësi, Murat Hoxha, ka thënë, se “gjatë këtij viti, i kemi përkrahur në vazhdimësi bujqit dhe fermerët malishevas, duke filluar me serra, pastaj me makina mjelëse, lopë qumështore, dhe shumë të tjera, përfshi edhe këtë ndihmë për bujqit, me motokultivator dhe sigurisht se kjo nuk do të jetë e fundit, por do